

STATUTI
I
SHOQËRISË TREGTARE
"HONEST BEER" SH.P.K

ME SELI NË TIRANË

Sot, më datë 30/10/2023 (dymijë e njëzetetër)

Z. Sokol Kraja, i biri i Gani dhe Ixhlal, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 04/06/1969, lindur në Tiranë dhe banues në adresën *Rruga Bardhok Biba, Galeria e Tiranës. Nr. 17 Tiranë, Shqipëri*, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.G90604128G

Dhe

Z. Adnan Hoxha i biri i Halit dhe Fetije, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 17.05.1962, lindur në Shkodër dhe banues në adresën *Rruga Bajram Curri 03310048, Nd. 29.H 1, Shkodër, 4001, Shqipëri*, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. G20517072M

Kane vendosur themelimin e shoqërisë "HONEST BEER" SH.P.K, dhe harton statutin me terma si më poshtë:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria Tregtare "HONEST BEER" SH.P.K, rregullon pozitën e saj juridike, marrdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrdhëniet e Shoqërive Tregtare

NENI 1.

Emri i Shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do të punëtojë në qarkullimin juridik-civil me emërtimin e saj "HONEST BEER" SH.P.K.

NENI 2

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Autostrada Tirane-Durres, km 8.8, Picar, Zona Kadastrale nr 3974, Nr pasurie 249/76, Vorë, Shqipëri.

Neni 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë.

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i papercaktuar mund të shkurtohet një ose disa herë vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve.



4

NENI 4.
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt veprimtarisë të saj:

- Marrja, perfitimi, apo prodhimi i produkteve të së drejtes intelektuale dhe tregimi apo dhënia në përdorim e tyre paleve të treta.
- Për arritjen e objektivave të shoqërisë, shoqëria do të ketë gjithashtu mundësinë të zhvillojë të gjitha operacionet tregtare, industriale, me të luajtshme e të paluajtshme që do të konsiderohen të nevojshme të dobishme nga organi administrativ.

NENI 5
Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakut të vetëm themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kontributi në para do të jetë i përbërë prej një kuote me vlerë 100,000 (njëqindmijë) lekë.

Ortakut themelues i Shoqërisë zotëron kuotat si më poshtë:

1. Z. Sokol Kraja, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50% të kapitalit fillestar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë me vlerë 50,000 (pesëdhjetëmijë)lekë
2. Z. Adnan Hoxha në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50% të kapitalit fillestar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë me vlerë 50,000 (pesëdhjetëmijë)lekë

Kapitali themeltar është derdhur tërësisht nga ortakët themelues. Vlera dhe pagesa e kapitalit themeltar do të kryhet në momentin e nënshkrimit të këtij akti themelues.

NENI 6.
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi.

Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dentojë kreditorët as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën gjykatat e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve

NENI 7
Financimet e Ortakëve

Ortakët mund të kryejnë financime në favor të shoqërisë me kundërshtëpërbim ose jo, me ose pa detyrimin e rimbursimit, në bazë të një vendimi nga ortakët

NENI 8



Abuzimi i ortakëve ndaj shoqërisë

Ortakët, e shoqërisë tregtare, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:

- a) abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
- c) në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

NENI 9

Ndalimi i konkurrencës

Ortakët nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë. Gjithashtu, ata nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.

Statuti mund të parashikojë që ndalimi i përmendur më sipër të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga ortakët, apo nga asambleja e përgjithshme me 51% votave.

Ky autorizim mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendur në të, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së kësaj cilësie.

Nëse ndonjëri prej ortakëve shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:

- a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
- b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
- c) të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.

Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej ortakëve:

- a) të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
- b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
- c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.

NENI 10.

Pronësia mbi kuotat.

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:


- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shit-blerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

NENI 11

Transferimi i kuotave nëpërmjet të gjallëve

Ortakët e shoqërisë në rastet e transferimit të kuotave rezervojnë të drejtën e parablerjes së kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Në një rast të tillë kur ortaku kërkon të shesë kuota ose pjesë të saj, duhet të njoftojë pranë organit administrativ dhe tek ortakët e tjerë, nëpërmjet një letër rekomande duke specifikuar çmimin dhe modalitetet e pagesës..



Brënda 30 ditëve nga ky komunikim, ortakët e tjerë duhet të lajmërojnë nëpërmjet një letër rekomande nëse duan ta ushtrojnë të drejtën e parablerjes. Cmimi i shitblerjes së kuotave duhet të jetë ai i tregut. Nëse ortakët që ka të drejtën e parablerjes kërkon të ushtroje edhe të drejtë, por nuk është dakord me cmimin e ofruar nga ortakët që shet kuotat, atëherë asambleja cakton një ekspert për vlerësimin e vlerës së kuotave që shiten duke përdorur metodat e vlerësimit bazuar në treg.

Kur afati 30 ditësh kalon pa asnjë lajmërim nga ortakët, atëherë e drejta e parablerjes do të konsiderohet e ezauruar. Në një rast të tillë transferimi tek të tretët do të kryhet nëpërmjet pëlqimit të Asamblesë së Përgjithshme, e cila duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës.

NENI 12 Vdekja e Ortakut

Transferimi i kuotave në rastin e vdekjes së një ortakut, si në mënyrë të veçantë dhe në mënyrë universale, do të kryhet sipas mënyrës së mëposhtme:

- shoqëria do të vazhdojë të kryejë aktivitetin e saj edhe vetëm me një apo të gjithë trashëgimtarët e të ndjerit.
- Për përcaktimin e vlerës së kuotës së ortakut të vdekur e cila i takon trashëgimtarit të të ndjerit, në rast të likuidimit aplikohet neni 15 më poshtë.

NENI 13

Largimi i ortakut nga shoqëria dhe likuidimi i kuotës

Ortakut mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkak të tjerë, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkak të arsyeshme.

Ortakut ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkak të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortakut që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.


Ortakut që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

NENI 14. Përfshirja e ortakut

Në bazë të një vendimi të asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:

- me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut
- me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.



Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

NENI 15 Likuidimi i kuotës

Në rastet e parashikuara më sipër në nenet 12, 13 dhe 14, kuotat do t'i likuidohen ortakut që largohet apo që përjashtohet, apo trashëgimtarëve të ortakut të vdekur në përpjestim me pasurinë e shoqërisë.

Pasuria e shoqërisë do të përcaktohet nga një raport i organit administrativ duke marrë njëkohësisht dhe mendimin e një eksperti kontabël, duke patur parasysh vlerën e tregut të kuotave të zotëruara në ditën e vdekjes së ortakut apo në ditën e marrjes së vendimit sipas ligjit për largimin apo përjashtimin të ortakut.

Likuidimi i kuotave të zotëruara duhet të realizohet brenda 180 ditëve nga dita në të cilën është vendosur likuidimi. Likuidimi mund të bëhet nëpërmjet blerjes së kuotave nga ana e ortakëve që mbeten në proporcion me pjesën e zotëruar prej tyre ose me shitjen e kuotave tek një person i tretë, i cili është miratuar nga ortakët e tjerë. Në rast se kjo nuk arrihet, atëherë likuidimi do të bëhet nëpërmjet përdorimit të rezervave ekzistuese të shoqërisë ose nëpërmjet zvogëlimit të kapitalit në proporcion me masën e kuotave që duhet të likuidohet, me përjashtim të rastit kur zvogëlimi vjen në kundërshtim me ligjin.

NENI 16 Administrimi dhe përfaqësimi

Shoqëria mund të administrohet në mënyrë të alternuar, me vendim të ortakëve sipas emërimit nga:

1. administratori i vetëm
2. nga dy apo më shumë administratorë me kompetenca të përbashkëta ose të veçanta


Në rast se administratorët emërohen pa ju referuar ndonjë rregulli për ushtrimin e kompetencave të administratorëve, do i bëhet referim rregullave të përgjithshme të ligjit 9901, datë 14/04/2008, i ndryshuar.

Administratorët mund të jenë dhe jo ortakë. Nuk mund të emërohen administratorë dhe në rast se janë emëruar shkarkohen, ata që janë subjekt i neneve 13 dhe 95 të ligjit 9901, datë 14/04/2008, i ndryshuar.

Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

Administratorët do të përfitojnë një shpërblim të miratuar nga ortakët, do të kenë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të kryera për arsye pune, si dhe do të përfitojnë një shpërblim në rastin kur largohen nga detyra. Shpërblimi i administratorëve për raset që nuk parashikohen nga ky statut do të bëhet sipas parashikimeve të bera në ligjin "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Asambleja e Përgjithshme mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për punë të veçanta apo grup punësh dhe ti revokojë ata, mund të emërojë drejtorë, zv. drejtorë dhe agentë, mund të ndërmarrë dhe përballet me çështje gjyqësore në çdo shkallë gjyqësore duke emëruar avokatë, përfaqësues dhe ekspertë dhe duke i revokuar ata.



Administratorët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Administratorët e parë të shoqërisë "HONEST BEER" sh.p.k do të jetë:

- **Z. Sokol Kraja**, i biri i Gani dhe Ixhial, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 04/06/1969, lindur në Tiranë dhe banues në adresën *Rruga Bardhok Biba, Galeria e Tiranës, Nr. 17, Tiranë, Shqipëri*, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.G90604128G, i cili e ka pranuar këtë detyrë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë.

dhe

- **Z. Adnan Hoxha** i biri i Halit dhe Fetije, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 17.05.1962, lindur në Shkodër dhe banues në adresën *Rruga Bajram Curri03310048, Nd 29,H 1,Shkodër,4001, Shqipëri*, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.G20517072M, i cili e ka pranuar këtë detyrë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë.

NENI 17.


Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve

Administratorët e shoqërisë veprojnë në mënyrë të përbashkët për drejtimin e shoqërisë.

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

1. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatitin dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
5. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
7. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
9. të thërrasin asamblesë e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aktiveve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim..

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Padi të, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.



Administratorët firmosin së bashku të gjitha dokumentet dhe aktet zyrtare të shoqërisë. Në mënyrë të veçantë lidhja e kontratave me klientët, furnitorët, veprimet a kryera për pagesat nga arka, llogaritë bankare, hapja apo mbyllja e llogarive bankare, blerja apo shitja e pasurive të luajtshme apo të pluajtshme, do të duhet të kryhen me firmën e përbashkët të dy administratorëve. Secili administrator ka të drejtë të delegojë kompetenca të tij administratorit tjetër me anë të një prokure të pocaçme.

Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nepermjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblese së përgjithshme. Kur njëri apo të dy administratorët japin dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, të dy administratorët e shoqërisë janë të detyruar të therrasin asambleshën e përgjithshme për emërimin e administratorit/reve të ri/nj, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit/reve të ri/nj në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori apo administratorët që japin dorëheqjen i njoftojnë me shkrim dorëheqjen Qendres Kombëtare të Biznesit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblese së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Biznesit regjistron largimin e administratorit/rëve, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", të ndryshuar. Dorëheqja e administratorit/rëve nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji."

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) japin kredi

Administratorët do të kenë të drejtë të bëjnë drejtimin e zakonshëm dhe administrativ.

NENI 18

Asambleja e Përgjithshme

Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme merr vendime me $\frac{3}{4}$ të votave në rastet si:

1. ndryshimet e statutit;
2. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
3. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
4. shpërndarjen e fitimeve;
5. raste të tjera të parashikuara nga ligji dhe statuti.

Për raste të tjera ajo vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës si më poshtë:

1. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
2. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të audituesve ligjorë;
3. përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe audituesve ligjorë.
4. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
5. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
6. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
7. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.



8. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
9. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
10. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë

Asambleja e Përgjithshme mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e përgjithshme thirret nëse:

- sipas pasqyrave financiare vjetore apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aktiveve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar
- Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.
- Në rastet e parashikuara në pikën 1 dhe 3 më sipër, përpara asamblesë së përgjithshme paraqitet një raport i përgatitur nga një ekspert kontabël i autorizuar i pavarur.
- Në rastet e parashikuara në pikën 1 dhe 3 më sipër, Asambleja e Përgjithshme mund të aprovojë një zgjidhje këshillimore duke aprovuar ose duke vezhguar aktivitetin e administratorëve.

NENI 19.

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 20.

Kuorumi i nevojshëm dhe vendim-marrja

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve. Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e demit



të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Në rast të mos arritjes së kuoromit të nevojshëm për marrjen e një vendimi, rithërritet mbledhja tjetër e asamblesë. Nëse përsëri nuk arrihet kuorumi i nevojshëm atëherë ortakët kanë të drejtë të drejtohen gjykatës së rrethit Tiranë për të vendosur.

NENI 21.

Procesverbali i mbledhjes së asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

NENI 22.

Hetimet e posaçme

Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit në të kundërt brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

NENI 23.



Përdorimi i të ardhurave neto.

E ardhura neto që rezultojnë mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloji aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin rezervën për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortakët, sipas qëllimeve të tyre.

NENI 24.

Pasqyrat Financiare vjetore dhe plani financiar.

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në pasqyrat financiare të saj në monedhë të vendit (ALL) ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.



Pasqyrat Financiare vjetore paraqiten brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e pasqyrave financiare përcaktohet nga Administratorët në harmoni me format e pasqyrave financiare të vendosura sipas ligjeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë.

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Regjistrimet dhe librat kontabël do të mbahen në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

NENI 25 Shpërndarja e fitimeve

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

NENI 26. Kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori/ët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme.

Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Administratori/ët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Administratori/ët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

NENI 27 Audituesi Ligjor.

Shoqëria cakton auditues ligjor për çdo vit financiar kur kërkohet sipas rasteve të përcaktuara në ligj.


Emërimin e tyre e bën Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.

Audituesit ligjorë mbajnë përgjegjësi për realizimin e verifikimeve dhe procedurave të tyre në përputhje me standardeet profesionale që rregullojnë punën e tyre si dhe për konfidencialitetin e të dhënave të fituara gjatë ushtrimit të detyrës së tyre pranë shoqërisë. Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga aktiviteti i parregullt i tyre ose verifikimi i tyre i gabuar.

Me vendim të ortakëve mund të caktohen për auditime specifike edhe ekspertë përkatës të fushës.

Nuk mund të ngarkohen me detyrën e audituesit ligjor, themeluesi, administratori, personat që janë gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt.

NENI 28



Marrëdhëniet e punës

Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontrates individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve. Marrëdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

NENI 29

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

PRISHJA E SHOQËRISË. LIKUJDIMI.

NENI 30

Kjo Shoqëri do të priset në rast kur:

1. merr vendim Asambleja e Përgjithshme;
2. hapen procedurat e falimentimit;
3. nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
4. merret një vendim gjykate;
5. Në raste kur njërti nga ortakët nuk zbaton kërkesat e marrëveshjes së bashkëpunimit të ortakëve datë 6.07.2023 Nr . rep 3069 nr koleksioni 882;
6. për arsye të tjera, të parashikuara në statut;

Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nga administratorët.

NENI 31

Likuidimi i shoqërisë

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.


Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër.

Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare priset me vendim gjykate. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse.

Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit.



Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet *ex officio*, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë aksionare ndiqet nga shënimi "në likuidim".

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

NENI 32.

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 33.

Bilancet e likuidimit

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet dhe Pasqyrat Financiare miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 34



Shpërndarja e aktiveve

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve apo aksionarëve. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

NENI 35

Likuidimi i thjeshtëzuar

Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përsheptuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët apo aksionarët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit. Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar. Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra.



DISPOZITA TË FUNDIT.

NENI 36

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 37

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 38

Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe u nënshkrua pa vërejtje nga ortaku themelues përpara vendit të themelimit.

ORTAKET THEMELUES

SOKOL KRAJA

Sokol Kraja

ADNAND HOXHA

Adnand Hoxha

Adnand Hoxha

(

